



Adresa: Rruga Nikolla Tupe, Nr. 17
Tirana, Albania
E-mail: danjela.shkalla@bktf-coalition.org
Phone: +355 68 20 26 662

Koalicioni Shqiptar “Bashkë Kundër Trafikimit të Fëmijëve”

Njoftim për Shtyp

Mbi Ligjin “ PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS”

5 Nëntor, 2010. Koalicioni **Shqiptar “Bashkë Kundër Trafikimit të Fëmijëve”** (BKTF)¹ mirëpret dhe përshëndet aprovimin dje në Parlament, të “Ligjit për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”.

Aprovimi i këtij ligji shënon një arritje të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë fëmijëve Shqiptarë përmes një kornize të plotë ligjore dhe institucionale dhe në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Ky ligj hap rrugën për ndërtimin e mekanizmave të përshtatshëm dhe efektiv institucional të cilët do të sigurojnë dhe garantojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve nga individët, familja, shteti ose palët e treta.

Ligji synon të ofrojë masat e nevojshme për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës, përmes veprimeve dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave të cilat punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Ky Ligj pritet që të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, përmes institucionalizimit të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve, si struktura të domosdoshme në nivel vendor, përgjegjëse për koordinimin e shërbimeve dhe në bashkëpunim me një sërë aktorësh të tjerë ofrues shërbimesh për mbrojtjen e fëmijëve dhe manaxhimin e rasteve në nevojë. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve janë pilotuar në 5 vitet e fundit, në 13 bashki dhe 4 Komuna në të gjithë territorin e Shqipërisë, përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile.

Koalicioni BKTF ka marrë pjesë aktive në procesin e draftimit të ligjit “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, duke ofruar rekomandime dhe komente, të cilat do të ndihmojnë në zbatimin në praktik të ligjit, si dhe duke u mbështetur në modelet e suksesshme dhe praktikat më të mira në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, të ndërmarra në bashkëpunim me njësitë vendore, në nivel komune dhe bashkie.

Koalicioni BKTF do të vazhdojë të mbetet i përkushtuar për të ofruar më tej kontributin dhe ekspertizën në hartimin e akteve nënligjore të nevojshme për të mbështetur zbatimin efektiv të ligjit, të cilat do të rregullojnë funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të parashikuar për mbrojtjen e fëmijëve në nivel kombëtar dhe lokal, si dhe koordinimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre strukturave, si dhe përgjegjësitë që rrjedhin në zbatimin e politikave, strategjive dhe ligjeve të tjera në funksion të mbrojtjes së fëmijëve.

Koalicioni BKTF vazhdon të mbetet i angazhuar për të monitoruar procesin e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore në mënyrë që të sigurohet me efektivitet mbrojtja tërësore e të drejtave të të gjithë fëmijëve në Shqipëri.

¹ BKTF është një koalicion prej 25 organizatash lokale dhe ndërkombetare të cilat punojnë dhe advokojnë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, nga të gjitha format e abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit dhe trafikimit. Këto organizata janë: Aksion Plus, Arsis, Terre des Hommes in Albania, Save the Children in Albania, Center for Integrated Legal Practices and Services, International Social Services, Partners for Children, Children of the World- Albania, Help for Children, World Vision, Tjeter Vizion, Center for Legal and Civic Initiatives, “Amaro Drom” Union, Volontariato Internazionale per lo Sviluppo Albania, Rromani Baxt, Tirana Legal Aid Society, National Center Education for Life, Association of Women ëith Social Problems, National Center for Community Service, Centro Informazione Educazione di Sviluppo, Caritas Albania, Coordinated Actions against Poverty, Center “Children Today”, SOS Villages, Bethany Social Services